



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "BiovetDDD" Sh.P.K. të datës 31.08.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve (fshirja, larja, pastrimi i kanalizimit atmosferik dhe ujëmbledhësve) – e ndarë në VI – LOT-e" me nr. të prokurimit 616-26-6509-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "BiovetDDD" Sh.P.K. të datës 31.08.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve (fshirja, larja, pastrimi i kanalizimit atmosferik dhe ujëmbledhësve) – e ndarë në VI – LOT-e" me nr. të prokurimit 616-26-6509-2-1-1.
- II. LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi** hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "BiovetDDD" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 31.08.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve (fshirja, larja, pastrimi i kanalizimit atmosferik dhe ujëmbledhësve) – e ndarë në VI – LOT-e" me nr. të prokurimit 616-26-6509-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe

nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "NE dosjen e tenderit dhe ne NJK keni percaktuar vleren e mjeteve te ndare per vitin 2026, 2027 dhe 2028, mirepo kjo nuk eshte e sqaruar se sa mjete jane ndare per secilin LOT sepse kjo ka rendesi te vecant per OE -- P.SH. vlere 550,000.00 €eshte planifikuar per vitin 2026 mirepo detajizoni nga kjo vlere sa jan te ndara per lot 1, 2, 3, 4, 5, dhe 6 ne menyre qe jene te njoftuar OE, po ashtu edhe per vitin 2027 dhe per vitin 2028 ne emnyre qe jene te informuar sakt OE se sa mjete do te ndhen per secilin lot vec e vec per secilin lot ne menyre qe te mund te tenderojme brenda vleres se parashikuar dhe mos te thuhet nga AK gjate fazes se vleresimit apo edhe gjate ekzekutimit te mos keni mjete financare sic ka ndodhur shpesh ne te kaluaren dhe kjo eshte e percaktuar edhe me dispozita ligjore sepse nuk guxon AK te hyjen ne mardhenje kontraktual me OE ne mungos te mjeteve fianancare dhe pastaj pasojat ti vuajn OE per fajin e AK per shkak te mos planifikimit te sakt me kohe?! TEK KVK kenispecifikuar: Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga Autoriteti Kontraktues për shërbimet e performuara ne baza mujore (ex post). Mirepo kerkojm te vendost edhe se pagesa nuk do te kaloj afatin ligjore te ekzekutimit 30 dite nga data e pranimi, sepse nga praktika nuk po respektohet ky detyrim ligjore dhe po detyrohemi te ndjekim rruge tjera per ekzekutim pagesa perms permbaruseve gje qe po ka kosto shtese dhe vonesa te parsyshem dhe te pa nevojshem per OE.

Kapaciteti teknik dhe profesional:: neni 9.1 & 9.2 te FDT-se janë si e vijim: Kërkesa

1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme si (Mirëmbajtje verore apo dimërore te rrugëve , Mirëmbajtje te kanalizimit), në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej LOT-I 1,275,000.00 €; LOT-II 825,000.00 €; LOT-III 525,000.00 €; LOT-IV 525,000.00 €; LOTV 600,000.00 €; LOT-IV 375,000.00 €;

Në rast konzorciumi Lideri duhet ti ketë 60% të vlerës së kërkuar për kontrata të ngjashme. Dëshmia 1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes së Tenderit ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje e punëve me sukses, nëse kontrata është me kompani private të dëshmohet me transaksion bankar (dëshmi qe është kryer pagesa).

LUSIM AK cilat jane tjerat kontrata te ngjashme pervec " Mirembajtjes verore apo/ose dimerose te rrugeve dhe Mirembajtja e kanalizimeve" te cilat jane te ngjashem dhe te cilat pranohen gjate fazes se vleresimit sepse kjo eshte shume e paqarte dhe ka shume kuptimesi andaj lusim te specifikoni cilat jane tjera kontrat qe jane te ngjashme dhe pranohen,,..... P.SH. Mirembajtja e parqeve, Mirembajtja e shesheve, mirembajtja dhe riparimi i vazrrevezave, - mirembajtja e rrethojave, Mirembajtja e objekteve te ndryshme, Pastrimi dhe mirembajtja e objekteve dhe hapsiave te jashtme, etjetj a pranohen dhe nese po te shtohet te gjithë ato kontrata te sherbimeve qe pranohen pervec atyre qe keni specifikuar " mirembajtja e rrugëve dhe kanalizimeve" Konsiderojm se kjo eshte e domosdoshme te sqarohet dhe te behet e ditur per te gjithë OE e intresuar se cilat jane ato sherbime qe pranohen dhejo ne fazene vlresimit te pranohen edhe kontrat tjera apo edhe te eliminohen OE te cilet ofrojn deshmi se kan kryer sherbime te ngjashme, sespe termi kontrata te natyrese se ngjashem eshte bukur i gjere dhe len hapsire per interpretim dhe dykuptimesi..... TJESHT te sqarohet sakt se cilat jane kontratat e tjera qe pranohen sikurse i permenda disa me larte dhe te cilat jane kontrata te sherbimeve dhe jane te

ngjashme?!///// sqaroni ne menyre te detajuar cilat kontrata tjera pranohen perveq atyre 2 (dy) qe keni permendur ju ne kerkesen nr. 1

Gjithashtu, nese i referohemi **nenit 26.10 te Rreg. Nr. 002/2024 per PP - verisioni i konsoliduar - (ndersa tek Udhezuesi nr. 002/2024 per PP ne faqe 33 thueht " lideri i grupit preferohet të përmbush se paku 51%"** ku AK-të mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave për gjendjen ekonomike dhe financiare nga lideri i grupit të OE. Prandaj konsiderojm dhe njashtu kerkojm qe AK te ule perqindjen nga 60% ne 51% ashtu sic e percaktojne dispozitat ligjore duke jap fleksibilitet me te madhe per OE dhe jo te shkoj me 60% sepse kjo perben kufizim dhe pengim te pa nevojshem per OE dhe u pamundeson OE te tenderojn dhe pastaj ne fazen e vleresimit kjo paraqet problem dhe veshtersi sepse mudn te parqiten edhe Ankesa sepse AK - KVEKT detyrohet te respektoj kete kerkes dhe sipas prakties nga e kaluar ky rregull ne fazene vleresimit eshte I pa mundur te respektohet?!... Andaj kerkojm te ulet nga 60% ne Q% sespe eshte I arsyshem proporcion dhe raport me qellimin e kontratas dhe mbi te gjithë eshte LIGJOR 51% ndera cdo percindje pertej kesaj vlere konsiderojm se eshte kufizues dhe diskriminus per OE Gjithashtu te ulet edhe tek kerkesa nr. 3 nga 60% ne 51% lidhur me numrin e puntoreve nga Lideri I grupit?! Aneksi 7 per te gjitha Lotet e sidomos per Lot 1 paisjet me nr. rendor nr. 2, 3, 9, 14 dhe 15 jane favorizuese dhe diskriminuese dhe ne shkeje te nenit 51 te LPP.

Lidhur me keto specifikim kaq specifike dhe striket perben kufizim per shume OE per faktin se shume paisje me specifika dhe pesha qe jane shuem afer me keto specifika perjashtohen dhe gjate fazes se vleresimit detyrohet Komisioni ose te shkel dispozitat ligjore dhe ti pranoj ose te respektoj LIGJIN dhe te elemnoj shume OE per shkak te ketyre specifikave kaq kufizuse dhe diskriminuese P.SH.:

1. Fshesë për pastrimin e shtigjeve të biçikletave dhe trotuareve me peshë totale min 1.5 deri max 1.9 ton - Psek ac speciakime 1.5 deri 1.9 pse nuk keni shkura sikur ted isa makineri tjera psh. Min. 1 deri max. 2.5 me rreit pak apo me lejuar devijimin e ketyre specifikave deri ne -/ 10% dhe jo me qene kaq striket sepse nje FSHISE me 1.2 apo edhe 2.2. e kryen te njejtin fuksion dhe nuk perjashtohen OE dhe funksioni mbetiti I njejte?!.....

2. Pastaj fshena poz. 3 min. 2 deri max. 2.7 pse bashë 2.7 ku e percaktuat kaq strikt p.sh. pse jo 2.8 apo 2.9 apo ose edhe 3 cka e dallon per kaq devijim lusim te shkoni me 2 deri 3 apo ose 2.5 apo edeh te jepni mundesin e devijimeve per te gjitha paisjet /- 10 % pranohet te gjitha paisjet bernda ketyre specifikave me devijimin e lajuar /- 10% atehere do te ishte me transparnte dhe do ti mundesont OE te tenderojn duke rritur edhe konkurencen dhe mundusuar vleresimin me te drejt pa shkelje ligjore, sepse si do te vepron nese une e sjell fshisen me Max. 2.9 apo edhe 3 sespe kemi hulumtuar tregun dhe kemi vrejtuar se keto pasije jan shume specifike dhe te veqanta dhe kane vetem nje numer I caktuar te OE dhe kjo eprben kufizim dhe nuk eshte ne perputhej me dispozitat ligjore te LPP-se.?!

3. Njete jane edhe ratet tjera e sidomos nr. 9, (min. 1.5 max 3.5 - pse te mos jete: 1-3 apo /ose 2-4 apo edhe keto port e lejohet devijimi /-10%) e sidmos e VEQANARISHT nr.14 -

Kamionetë me kabinë të dyfishtë (double cabin) për transport të stafit dhe pajisjeve: me minimum 6 vende, gjate hulmtimit tone te tregut ne Kosoves ky lloj I kamionetave eshte shume I rralle dhe ne kosove jane vetem dy Copa qe ne kemi arrit ti gjejem dhe eshte e pamundur edhe ti marresh me qira sepse jane percaktuar per cilet OE I japin me qira dhe kjo perpbn shume kufizim, PSE ME 6 ULESE eshte problem I OE se si ti leviz dhe bart punetoret. Kjo kerkes nuk eshte proporcional dhe drejperdjete me natyren e sherbimeve, sepse AK duhe te vendos pasije qe kryjen sherbimet por jo te hyj edhe ne kufizime te bartjes se punetoreve nga OE deri ne vendpunishte ?????!.... Te largohet nr. I uleseve apo te behet me 2 apo edhe 4 por jo edhe me 6 Ulese spse kjo perben shume kufizim dhe kjo mund te ndikoj ne rritjen e cmimeve sepse kete lloj te pisjeve mund te posedoj

vetem nje OE dhe kjo perben diskrimin dhe kufizim te pa nevojshem dhe nuk eshte ne raport te drejtperderjt me netyren e sherbimeve dhe qellimin e kontrates ashtu sic kerkohet me nenin 51 te LPP-se. Po ashtu, pesha e kesaj fshise eshte vendosur vetem pesha MAX. 2000 Kg pse te mos jete: psh. 2.5 apo edhe 3000KG dhe me kete ndryshim perseri ruhet funksioni i njejte dhe kryerja e sherbiemve per sheshe, lusim ta analizoni dhe te mundosni transparenc me temadhe dhe konkurrenc me te madhe apo duke vendosur edhe per seiciln paisje divijimin: /-10%".

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, sipas nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast janë kërkuar sqarime pikërisht nga njësia kërkuese të cilave u është falur besimi i plotë. Sqarime e ofruara nga njësia kërkuese lidhur me pretendimet ankimore janë si në vijim: "Ndarja e vlerës së parashikuar sipas viteve dhe loteve: Dosja paraqet vlerën totale, vlerën e secilit lot dhe planifikimin vjetor të aktivitetit. LPP kërkon që vlera e parashikuar të përcaktohet me kujdes dhe të mos përdoret për shmangien e rregullave të prokurimit; nuk rezulton një detyrim që në Dosjen e Tenderit të shpërndahej paraprakisht secila kësht-vlerë vjetore për secilin lot, kur kontrata zbatohet sipas nevojave, sasive të porositura dhe ndarjeve buxhetore. Operatorët ofertojnë sipas listës së çmimeve dhe sasive të parashikuara, jo sipas një garancie të realizimit të plotë të çdo vlere vjetore. Pretendimi rrjedhimisht nuk provon shkelje. Kushti për pagesë mujore ex post rregullon mënyrën e faturimit. Afatet e pagesës burojnë nga kontrata dhe legjislacioni financiar i zbatueshëm; kërkesa për ta shtuar formulimin '30 ditë' është propozim kontraktual i operatorit, jo provë se Dosja ekzistuese shkel LPP-në.

4. Kontratat e natyrës së ngjashme: Shprehja 'të natyrës së ngjashme si' lejon vlerësim funksional të kontratave që kanë përmbajtje, kompleksitet dhe resurse të krahasueshme; ajo nuk e kufizon domosdoshmërisht përvojën vetëm në titullin formal të dy shërbimeve të përmendura. AK nuk mund të japë paraprakisht listë shteruese të çdo kontrate të mundshme, sepse ngjashmëria vlerësohet mbi përmbajtjen e dëshmisë. Prandaj pretendimi për paqartësi dhe diskriminim nuk është provuar.

5. Kërkesa prej 60% për liderin e grupit: Referenca e parashtruesit se lideri 'preferohet' të përmbushë së paku 51% nuk krijon kufi maksimal ligjor prej 51%. Vetë formulimi orientues lejon që AK, në varësi të natyrës, vlerës, kompleksitetit dhe rrezikut të kontratës, të caktojë përqindje minimale për liderin. Kërkesa 60% synon që subjekti që udhëheq grupin dhe bart përgjegjësinë kryesore të demonstrojë kapacitetet real për pjesën mbizotëruese të kontratës. Parashtruesi nuk ka paraqitur analizë tregu ose provë se ky prag është i paarritshëm apo i përshtatur për një operator të caktuar. I njëjti arsyetim zbatohet për kërkesën mbi personelin, me kusht që njësia kërkuese ta ketë dokumentuar proporcionalitetin në dosjen e aktivitetit.

6. Pajisjet, peshat dhe toleranca e kërkuar +/-10%: Sipas neneve 28 dhe 51 të LPP-së, AK ka të drejtë dhe detyrim të përkufizojë kërkesat teknike dhe kapacitetet minimale që lidhen me objektin e kontratës dhe janë proporcionale me të. Kufijtë e peshës dhe kapacitetit nuk janë marka tregtare dhe nuk dëshmojnë vetvetiu favorizim; ato mund të përcaktohen nga gabariti i zonave të punës, ngarkesa në trotuare e shtigje, manovrueshmëria, kapaciteti operativ, siguria dhe ndikimi në infrastrukturë. Kërkesa e operatorit për tolerancë të përgjithshme +/-10% është propozim alternativ. LPP nuk e obligon AK-në të pranojë devijim numerik kur kufiri paraqet kërkesë minimale/maksimale

funkionale. Pajisja jashtë kufirit mund të ketë ndikim tjetër në ngarkesë, manovrim ose produktivitet, edhe nëse kryen funksion të ngjashëm. Arsyetimi teknik i njësisë kërkuese për pozicionet 2, 3, 9, 14 dhe 15 duhet t'i bashkëngjitet këtij vendimi si Aneksi 1; pa këtë aneks, mbrojtja e proporcionalitetit para OSHP-së dobësohet. Për kamionetën me kabinë të dyfishtë dhe minimum gjashtë vende, kërkesa lidhet me transportin e njëkohshëm të ekipit dhe pajisjeve, zvogëlimin e lëvizjeve të panevojshme dhe reagimin operativ. Pretendimi se në Kosovë ekzistojnë vetëm dy automjete nuk është mbështetur me hulumtim të verifikueshëm të tregut, oferta furnitorësh ose prova që qiraja/blerja është e pamundur. Detyrimi i operatorit për të siguruar mjetet e nevojshme mund të plotësohet përmes pronësisë, qirasë ose marrëveshjeve të tjera të lejuara nga Dosja.

7. Kabinat sanitare dhe sasi të 10/600: Shifra '10' në listën e kapacitetit teknik paraqet [TË KONFIRMOHET: numrin minimal të kabinave që OE duhet t'i ketë në dispozicion njëkohësisht], ndërsa shifra '600' në paramasë paraqet [TË KONFIRMOHET: njësi faturimi/shërbimi gjatë tërë kohëzgjatjes së kontratës, p.sh. copë-muaj ose intervenime]. Këto dy të dhëna kanë funksione të ndryshme dhe nuk janë kontradiktore. AK duhet ta plotësojë saktë tekstin në kllapa dhe të bashkëngjisë faqet përkatëse të paramasës. Nëse të dyja shifrat realisht i referohen së njëjtës sasi fizike, kërkohet korrigjim i Dosjes; kjo nuk duhet të paraqitet si e pabazuar pa u sqaruar. (sasia 10 e taulet kabinave është parapre që gjatë fazes së ofertimit duhet t'i dëshmojë që i posedon, ndërsa sasi 600 është sasi e cila duhet të realizohet gjatë realizimit të kontratës).

8. Afati për sqarime dhe afati për ofertim: Nga kronologjia rezulton se janë publikuar sqarime dhe korrigjime. Neni 53 i LPP-së dhe dispozitat për sqarimet kërkojnë trajtim të barabartë dhe publikim të përgjigjeve pa identifikuar burimin. Parashtruesi nuk ka demonstruar se ndonjë operator ka marrë informacion tjetër ose më herët. Kërkesa për zgjatje të afatit vlerësohet sipas materialitetit të ndryshimeve dhe afateve minimale ligjore; dëshira për më shumë kohë, pa dëshmuar pamundësi objektive dhe pa identifikuar ndryshim material, nuk krijon vetvetiu detyrim për zgjatje".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.09.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.